

Raport nga pjesëmarrja në takimin e organizuar në Ohër të Maqedonisë

Organizatori:

- PM Group – Projekti për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve

Vendi:

- Ohër – Maqedoni

Pjesëmarrësit:

- PM Group – ekspert të fushave të mjedisit dhe pylltarisë nga Bullgaria dhe Maqedonia dhe ekspertë të projektit,
- MMPH – Mahir Yagcilar, ministër i MMPH-së, Fikrim Damka, këshilltar në MMPH, Luan Nushi, drejtor në IPH, Hazer Dana, drejtor në DPN, Ismail Hetemaj, udhëheqës i Divizionit për Mbrojtjen e Natyrës,
- MBPZHR – Nijazi Idrizi, Këshilltari i ministrit, Muzafer Luma, kryeshef i APK-së,
- Komisioni Parlamentar për çështje të Bujqësisë dhe Planifikimit Hapësinor – Ibrahim Selmanaj, anëtar

Agjenda:

Dita	Koha	Aktivitetet	Shënime/Vrejtje
E mërkurë 05 nëntor	Mëngjes	Udhëtimi nga Prishtina te Liqeni i Ohrit në Maqedoni	Parashikoni një udhëtim 6 orësh duke përfshirë kalimet e kufirit dhe drekën
	Pasdite / mbrëmje	Arritja në Hotel	Darka në hotel
E enjte 06 nëntor	Mëngjes	Vizita në Parkun Nacional Galicica, Maqedoni	Stafi i zonave të mbrojtura
	Pasdite	Prezantimi i modelit të menaxhimit institucional të Parkut Nacional të Pelisterit	Slavko Demeski, Parku Nacional i Pelisterit, Bitola
E premte 07 nëntor	Mëngjes	Prezantime nga Henry Phillips, Ludmila Dimitrova, dhe Georgi Tinchev	
	Pasdite	Konferencë e udhëhequr dhe moderuar me agjendë mbi të cilën është arritur pajtim paraprakisht Përfundime, marrëveshje dhe vendim-marrje	Moderuar nga Georgi Tinchev dhe Ergin Hajredini
E shtunë 08 nëntor	Mëngjes	Kthimi në Prishtinë	

Tema e takimit: Menaxhimi i Parkut Nacional “M.Sharr”

Menaxhimi efikas dhe i qëndrueshëm i PN “M.Sharr” është sfida kryesore e identifikuar në mesin e sfidave që janë paraqitur në kuadër të punës që është duke u zhvilluar në hartimin e Planit Hapësinor për PN. Drejtoria e PN si autoritet i përcaktuar nga MMPH, Drejtoria paralele e PN e instaluar në Komunën e Shtërpcës si dhe Agjencioni i Pyjeve të Kosovës të cilit, Ligji për Pyjet e Kosovës i jep kompetenca në menaxhimin e pyjeve edhe në kuadër të parqeve nacionale, janë tri institucione që momentalisht kanë kompetenca formale dhe joformale në asetet e territorit të PN. Prandaj, këto janë edhe arsyet e mjaftueshme që kemi insistuar në një takim të përbashkët, ku do të arrihet një marrëveshje për ndarjen e qartë të përgjegjësisë - kur është në pyetje menaxhimi i parqeve nacionale, në këtë rast Parkut Nacional “Mali Sharr”.














Takimi u organizua në Ohër të Maqedonisë, me pjesëmarrës të të dy ministrive dhe përfaqësues ekspert të projektit për menaxhimin e pyjeve të Kosovës. Në mesin e pjesëmarrësve ishin edhe përfaqësues të institucioneve maqedonase dhe bullgare të cilët së bashku me ekspertët e projektit prezantuan përvoja nga më të ndryshmet të cilat ndihmuan që në përfundim të takimit të pajtohemi në parim me një marrëveshje të përbashkët e cila në fakt paraqet një listë të aktiviteteve dhe përgjegjësve kryesor.

Përmbajtja e marrëveshjes:

Draft marrëveshja mes MMPH-së dhe MBPZHR-së për menaxhimin e parqeve nacionale

Ne vazhdimësi te prezantimeve te kryera ne Liqenin e Ohrit ne mes te dy Ministrive (MBPZHR & MMPH), është arritur marrëveshje ne parim qe pikat e mëposhtme do te përcaktojnë përgjegjësitë e institucioneve te përmendura sa i përket Menaxhimit me Parkun Nacional:

-  **Politikat**
 - MMPH do te jete udhëheqëse e procesit te politikave për parqet nacionale me pjesëmarrje te palëve tjera me interes
-  **Sigurimi i burimeve financiare**
 - MMPH është përgjegjëse për sigurimin e fondit për funksionimin normal te administratës se Parkut
-  **Hartimi i Planit Hapësinor**
 - MMPH do te jete udhëheqëse e procesit te hartimit te Planit Menaxhues ne bashkëpunim me palët me interes
-  **Hartimi i Planit Menaxhues**
 - MMPH do te jete udhëheqëse e procesit te hartimit te Planit Menaxhues ne bashkëpunim me palët me interes
-  **Aprovimi i Planit Menaxhues**
 - Qeveria ose Kuvendi
-  **Implementimi i Planit Menaxhues**
 - MMPH përmes drejtorisë se Parkut Nacional
-  **Aktivitetet Pyjore**
 - Ne pajtim me planit Menaxhues te parkut dhe planin Menaxhues te pyjeve dhe sipas Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedise, kryhen nga APK nen monitorimin e autoritetit te parkut.
-  **Biodiversiteti / Aktivitete e mirëmbajtjes**
 - Përgjegjëse MMPH
-  **Zhvillimi i eko-turizmit**
 - Duhet te behet ne harmoni me Planin Hapësinor dhe Planin Menaxhues nen monitorim nga DPN me përfshirjen e palëve te interesit.
-  **Komunikimi me banoret lokal dhe vizitoret**
 - Përgjegjëse DPN
-  **Kontrolli i përditshëm (prerjeve, vizita etj.)**
 - Përgjegjëse DPN edhe inspektoratet e ndryshme.

Hapi i ardhshëm është qe finalizimi i kësaj marrëveshje të behet brenda këtij muaji pas takimit ne Prizren ne mes te Komisionit Parlamentar dhe Ministrave te MBPZHR dhe MMPH.

Ohër,
Data 7 Nëntor 2008

Pjesëmarrësit: Mahir Yagcilar, Fikrim Damka, Ibrahim Selmanaj, Nijazi Idrizi, Muzafer Luma, Ismajl Hetemaj, Luan Nushi, Hazer Dana, Ergin H Jaredini,
Grupi Këshillues: Henry Phillips, Georgi Tinchev, Slavko Dameski, Andreë Mitchell, Lyudmila Kirilova Dimitrova, Dobromira Dimova, Valton Dreshaj

Marrëveshjen e arritur e konsiderojmë si një hap të rëndësishëm drejtë gjetjes së formës më efikase të menaxhimit me resurset e PN. Ajo (forma e menaxhimit) gjithsesi që duhet të jetë në harmoni dhe e ngjashme me format që po aplikohen në shtetet e përparuara dhe si e tillë të na shërbejë për ngritjen e nivelit të mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi.

Shpresojmë se takimi i paralajmëruar do të ndikojë që marrëveshja e dakorduar në parim, të fitojë në përmbajtje, duke i definuar edhe më tej detajet për përgjegjësit dhe detyrat e tyre.

Luan Nushi, drejtor në IPH, Pjesëmarrës në takim